



K.S

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT URBAN
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 402/1 Prot.

Elbasan, më 06.02.2023

Lënda: Kthim përgjigje

-Znj. Rashela Shehu (adresa postare Rr.Elbasan-Tirane,"Hysen Çino" 18, Tirana 1001)"

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana juaj, për dhënien e informacionit të detajuar, që disponon Bashkia Elbasan për subjektin me emrin tregtar "Kurum", referuar ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ju informojmë se është trajtuar nga struktura përkatëse e Bashkisë Elbasan me shpjegimet e mëposhtëme.

Të dhënat e dokumentuara në institucionin e Bashkisë Elbasan mbi subjektet private, janë grumbulluar bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Këto informacione nuk mund të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato të arsyeshme të grumbullimit të tyre, nga persona apo subjekte të pa autorizuar.

Kuptimi i të drejtës për akses nënkupton të drejta dhe akses vetëm mbi të dhënat tuaja personale apo të të gjitha shërbimeve të marra në Bashkinë Elbasan nga vetë subjekti kërkuar, dhe nuk mund të kenë asnjë informacion mbi subjekte të tjera.

Kërkesa të tilla për informacion nga subjekte të pa autorizuar duke mos ditur qëllimet e tyre, bëhen shkak për të cënuar sigurinë, interesat ekonomik dhe financiare të subjektit në fjalë.

E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

- a. të drejtën për një jetë private;
- b. sekretin tregtar, etj

Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të sipërcituara, nuk zbatohet kur subjekti i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin e bashkëpunimin !

KRYETAR
Gledian LLATJA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËNKRYETAR
Jetjon Gjura

